




ALEANCA PËR FËMIJËT SHQIPËRI



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

KARTA RAJONALE RAPORTUESE – QARKU DURRËS

“Situata e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror” për vitin 2011



QARKU DURRËS

Eksperti Rajonal
Dorina Beqiri dhe Endri Tahiri

LISTA E SHKURTIMEVE

VKM	– Vendime të Këshillit të Ministrave
Observatori	– Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Durrës
ACA	- Aleanca Për Fëmijët në Shqipëri
NJDF	- Njësia për të Drejtat E fëmijëve
DAR	- Drejtorinë Arsimore Rajonale
DSHP	- Drejtorinë e Shëndetit Publik
DRSHSSH	- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

I. Parathënie dhe falënderime

Observatori për të drejtat e fëmijëve është një strukturë e shoqërisë civile e financuar nga UNICEF- Shqipëri dhe ‘Aleanca për fëmijët’. Zbatimi i këtij projekti ka filluar në Mars të vitit 2009 duke u shtrirë tashmë në 12 qarqe, fillimisht në Tiranë Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Durrës, Kukës, Vlorë dhe Gjirokastër dhe së fundmi në Fier, Lezhë dhe Berat. Nga zbatimi I këtij projekti synohet të ngrihen mekanizma për vëzhgimin dhe mbledhjen e informacionit në lidhje me situatën e të drejtave të fëmijëve në secilin qark.

Zyrat e observatorit funksionojnë si zyra të shoqërisë civile që kanë për qëllim forcimin e aleancës dhe bashkëpunimin me të gjithë institucionet e mundshme për arritjen efektive për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Misioni i Observatorit është të kontribuojë në evidentimin e problemeve që mund të dalin gjatë zbatimit të të drejtave të fëmijëve. Si dhe të monitorojë në mënyrë të pavarur dhe të vazhdueshme për të arritur një nivel pune sa më të mirë në zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve’.

Observatori Durrës ka krijuar bashkëpunim të suksesshëm me 6 Bashki dhe 10 komuna në nivel qarku. Gjithashtu ka krijuar bashkëpunim shumë të suksesshëm me Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR) Durrës, Drejtorinë e Shëndetit Publik (DSHP) Durrës, me Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH) Durrës, institucione të cilat kanë dhënë një ndihmesë shumë të madhe në punën tonë si Observator duke na ndihmuar me statistikat e tyre rreth fëmijëve duke nxjerrë kështu një raport mbi gjendjen në të cilën është situata e fëmijëve në qark. Observatori ka bashkëpunim edhe me OJF të tjera që kanë në fokusin e tyre fëmijët dhe me to ka bashkëpunuar e ka marrë pjesë në zbulimin e rasteve të mos respektimit së të drejtave të fëmijëve dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme për fëmijët.

Gjatë periudhës së ekzistencës së tij, Observatori ka arritur të realizojë raporte të përgjithshme e specifike rreth gjendjes së fëmijëve në qarkun përkatës. Këto raporte u janë prezantuar në nivel kombëtar dhe lokal institucioneve publike dhe jo publike.

Studimi për “Fëmijët Jashtë Kujdesit Prindëror “ u ndërmor nga Observatori për të drejtat e Fëmijëve pasi kjo është një temë shumë delikate dhe ka shumë për të bërë nga institucionet shtetërore për rritjen e cilësisë së jetesës së tyre. Deri në momentin që flasim janë ndërmarrë hapa të mëdha nga pushteti për të ndryshuar këtë pjesë të fëmijëve por asnjëherë nuk mund të themi se është bërë gjithçka, duhet akoma punë për këtë target grup. Për këtë arsye Observatori ka nisur një studim rreth situatës së fëmijëve jashtë kujdesit prindëror dhe institucioneve të cilët i strehojnë këta fëmijë

Fokus grupi për këtë studim i referohet fëmijëve jashtë kujdesit prindëror. Puna për këtë grup ka filluar me vizitën në qendrat rezidenciale (shtëpitë e fëmijëve) në të gjithë qarkun e Durrësit. Në qark janë 2 institucione rezidenciale publike dhe 3 institucione jopublike që strehojnë fëmijë të cilët mund të jenë jetim biologjik ose jetim social. Në realizimin e këtij studimi kanë kontribuar stafi i qendrave rezidenciale si Drejtoresha znj Heroina Duka dhe stafi i saj: znj Geralda Allabaku, znj Migena Arrësi dhe znj Daniela Deliallisi si dhe stafi i qendrës rezidenciale në Bubq Drejtuesja znj Monika Bolonja, dhe z. Arqile Moisiu të cilët i falënderojmë për ndihmesën që dhanë me informacionet rreth gjendjes së qendrave përkatëse, situatën aktuale të fëmijëve dhe lehtësimin në punën për evidentimin e problemeve që mund të kenë .

II. Hyrja

Synimet dhe qëllimi i këtij studimi janë të nxjerrë në pah situatën e fëmijëve të cilët janë jashtë kujdesit prindëror si dhe të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror me Aftësi të Kufizuar, ku përfshihet: numri i fëmijëve të cilët ndodhen jashtë kujdesit prindëror në të gjithë qarkun, numri i qendrave rezidenciale ku strehohen këta fëmijë dhe gjendja e qendrave sipas standardeve të parashikuara.

Ky studim synon të përshkruajë gjendjen e kësaj kategorie fëmijësh dhe të japë disa sugjerime për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre e të mbrojë interesat e tyre nëse konstatohen shkelje të të drejtave të tyre në qendrat rezidenciale e jashtë tyre. Këto rekomandime do të jepen nga monitorimi i gjendjes së fëmijëve dhe qendrave ku ata jetojnë dhe shërbimeve që ata përfitojnë nga qëndrimi në këto qendra.

Ky studim i shërben të gjithë komunitetit dhe veçanërisht institucioneve me të cilat observatori bashkëpunon siç janë: Qarku Durrës, bashkitë dhe komunat në të cilat ndodhen qendrat rezidenciale. Ky raport shërben për të parë situatën e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror, problematikat që dalin prej tij dhe rekomandimet të cilat do të shërbejnë për të ngritur strategji të reja në mbrojtje të interesave të fëmijëve, veçanërisht atyre të cilët janë jashtë kujdesit prindëror që janë dhe qendra e këtij studimi.

Observatori ka zgjedhur qarkun Durrës për çështjen e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror pasi në këtë qark përqendrohet numri më i madh i qendrave rezidenciale e ditore të cilat janë publike e jo publike dhe në këto qendra ka fëmijë të cilët vijnë edhe nga qarqet e tjera për tu strehuar këtu. Ky përqendrim e bën qarkun Durrës favorit në këtë projekt.

Targeti i këtij studimi janë fëmijët 0-18 vjeç të cilët janë jashtë kujdesit prindëror si edhe fëmijët jashtë kujdesit prindëror të cilët janë me Aftësi të Kufizuara dhe që strehohen në qendra rezidenciale me staf të trajnuar posaçërisht për këtë kategori fëmijësh.

Burimi i informacionit janë bashkitë dhe komunat e qarkut Durrës Drejtoria Arsimore Rajonale, Drejtoria e Shëndetit Publik, Shërbimi Social Shtetëror si dhe qendrat rezidenciale publike e jo publike ku janë zhvilluar takimet me vetë fëmijët dhe është parë nga afër gjendja e tyre.

Metodologjia e përdorur gjatë zhvillimit të raportit

Për realizimin e këtij raporti është përdorur legjislacioni Shqiptar si dhe dokumente strategjike lokale e kombëtarë, është marrë informacioni i drejtpërdrejtë nga qendra të ndryshme që ofrojnë shërbime për grupmosha të tilla si dhe Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, gjithashtu duke iu referuar edhe botimeve të ndryshme rajonale, kombëtare, e ndërkombëtare që kanë si fokus fëmijët e braktisur dhe ato me aftësi të kufizuar.

Ky studim është bazuar në fokus grupet e realizuara nga vetë Observatori. Janë realizuar takime në ditë të ndryshme ku: një takim i fokus grupit është realizuar në Shtëpinë e foshnjës Durrës e cila është e ndarë në dy shtëpiza (një në qendër të rrethit Durrës dhe tjetra në periferi të qytetit) me kapacitet 30 fëmijë por aktualisht qendra në Shkozë e cila funksionon si qendër ditore dhe rezidenciale ku strehohen fëmijë të qarkut Durrës por edhe përtej, të cilët janë fëmijë nga familje me probleme sociale, të trafikuar, etj, ka 19 fëmijë të moshës 0-18 vjeç. Ky takim konsistoi i

ndarë në dy seanca ku në seancën e parë u realizua takimi vetëm me stafin dhe seancën e dytë u realizua takimi me fëmijët e qendrës.

Fokus grup ishte edhe shtëpia e fëmijëve “Betania” qendër rezidenciale jopublike që ndodhet në Bubq, rrethi Krujë, e cila aktualisht ka 70 fëmijë të strehuar në të. Qendra “Betania” përbëhet nga një staf i kualifikuar e cila funksionon dhe financohet nga shoqata “mëmë” më të njëjtin emër dhe me qendër në Itali.

Një nga pengesat e këtij raporti është fakti se bashkitë/komunat e Qarkut Durrës nuk kanë një numër të saktë të fëmijëve të cilët janë jashtë kujdesit prindëror, të cilët nuk qëndrojnë në qendra rezidenciale. Kjo kategori fëmijësh janë ata të cilët janë nën kujdesin e familjarëve të tyre, persona me të cilët ata kanë lidhje gjaku, ose fëmijë fati i të cilëve nuk dihet.

Në përfundim të këtij raporti pritet të dalin në pah të gjitha çështjet e respektimit dhe të mosrespektimit të të drejtave të fëmijëve dhe specifikisht të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror, problemeve që kjo kategori fëmijësh ka. Ky raport synon tu vijë në ndihmë të gjithë institucioneve publike dhe jo publike me të cilat Observatori bashkëpunon dhe jo vetëm. Ky raport synon që të shërbejë dhe si instrument lobimi për të drejtat e fëmijëve në qarkun Durrës. Ky raport mund të shërbejë si shtysë për hartimin e politikave sociale apo strategjive për fëmijët pa kujdes prindëror për të gjitha institucionet si lokale dhe kombëtare.

III. Analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror në qarkun Durrës.

Qyteti i Durrësit është qyteti i dytë për nga zhvillimi ekonomik e social në vend, pas qytetit të Tiranës. Qarku i Durrësit në vitin 2010 kishte një numër total popullsie 414326 banorë dhe në vitin 2011 qarku i Durrësit numëron 414603 banorë¹. Pra siç vihet re ka një ulje të popullsisë prej 277 banorë.

Fëmijët të cilët janë jashtë kujdesit prindëror dhe janë të braktisur e kanë shumë të vështirë aksesin tek shërbimet që ofrohen për të gjithë fëmijët. Vetëm nëse strehohen në qendrat rezidenciale të posaçme për to, atëherë fëmijët mund të kenë akses në shërbimet sociale si shkollimi apo përfitimi nga shërbimi mjekësor. Gjithsesi qendrat rezidenciale për fëmijët e braktisur kanë psikologë të cilët kanë për detyrë mbështetjen e fëmijëve psikologjikisht në momentin që hyjnë në qendër. Fëmijëve në këto qendra u merret mendim në lidhje me shkollën që dëshirojnë të ndjekin, veshjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Për çdo fëmijë në momentin kur hyn në qendrën rezidenciale hapet një dosje private dhe mbahet çdo ecuri e tij shëndetësore, arsimore apo çdo proces i lidhur me zhvillimin e tij psiko-social.

Qendrat rezidenciale që funksionojnë në qarkun Durrës janë përkatësisht:

Institucione rezidenciale publike për fëmijë

¹ Burimi i informacionit është INSTAT, viti 2011

1. Shtëpia e foshnjës Durrës e ndarë në dy shtëpiza me kapacitet *30 fëmijë* por aktualisht ka *19 fëmijë* të cilët janë jetimë ose vijnë nga familje të varfra dhe nuk kanë mundësi të mbahen nga familjet e tyre.
2. Qendra e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara e cila ka një kapacitet prej *44 fëmijë* nga të cilët *39 fëmijë* janë jashtë kujdesit prindëror.

Institucione rezidenciale jopublike për fëmijë:

1. Shtëpia e fëmijëve “Betania” në Bubq me *67 fëmijë* ku përfshihen fëmijët jetim biologjik , dhe jetim social te cilët vijnë nga familje me probleme sociale.
2. Shtëpia e fëmijëve “Shtëpia Orthodokse e Shpresës” në Shën Vlash me kapacitet *25 fëmijë*, por aktualisht ka *21 përfitues fëmijë* jetim e me probleme sociale
3. Shtëpia e fëmijëve “Brezi i Zgjedhur” në Thumanë me *9 fëmijë* jetim e nga familje me probleme sociale.

Qendra ditore publike për fëmijë:

1. Qendra ditore për fëmijë në Shtëpinë e foshnjës Durrës me *28 fëmijë* të familjeve pa të ardhura si dhe me probleme sociale;

Qendra ditore jopublike për fëmijë:

1. Qendra ditore për fëmijë “Dielli i Mëngjesit” me kapacitet *15 fëmijë* dhe që aktualisht ka *12 fëmijë* të moshës 3-6 vjeç, të cilët vijnë nga familje me probleme ekonomike si dhe fëmijë të komunitetit Rom;
2. Qendra ditore për fëmijë e fondacionit “Qendra Kristiane e Durrësit” e cila ka një kapacitet prej *50 fëmijësh* por aktualisht ka *40 fëmijë* të moshës 3-13 vjeç, të cilët vijnë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian si dhe familjeve me vështirësi ekonomike;
3. Qendra ditore e fondacionit “Nehemia”, Durrës me kapacitet *60 personash* dhe me *57 përfitues*, fëmijë të familjeve Rome e me vështirësi ekonomike;
4. Qendra ditore “Sot Për të Ardhmen” me *35 fëmijë* të moshës 6-15 vjeç të familjeve me probleme ekonomike;
5. Qendra ditore “Lulet e Fushës” në Maminas me një kapacitet prej *50 personash* por aktualisht është e mbingarkuar me *56 fëmijë* që vijnë nga familje të varfra;

Këto qendra rezidenciale ofrojnë shërbimet kryesisht për fëmijë jetim, fëmijë të trafikuar, fëmijë të nënave të trafikuar e te braktisur për shkak të problemeve sociale dhe ekonomike.

Qendrat ditore ofrojnë shërbime për fëmijë të familjeve me probleme ekonomike, sociale si dhe për fëmijët Rom dhe Egjiptianë. Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 Buxheti i cili jepet direkt nga ministria e punës çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta është standard për të gjithë qendrat rezidenciale dhe është 330lekë/person në ditë, sipas udhëzimit nr. 5 datë 01.05.2012 për nivelin e kuotave për ushqim në institucionet publike rezidenciale. Sipas drejtueses të shtëpisë së foshnjës në Durrës, kjo është një shumë e mjaftueshme për nevojat e një fëmije.

Gjatë vizitave në qendrat rezidenciale në qarkun e Durrësit janë identifikuar disa burime financiare në varësi të qendrës ; publike (fondet e të cilave vijnë nga Ministria e Punës dhe Bashkia) dhe jopublike (fondet e të cilave vijnë nga shoqata ose fundacione dhe nga të cilat varen drejtpërdrejt). Gjithashtu ka dhe donatorë të ndryshëm të cilët herë pas here ndihmojnë në mënyra të ndryshme si nga ana financiare ashtu dhe nga ajo materiale siç janë Ambasada Amerikane, Britanike dhe Italiane si dhe kompani të ndryshme si AMC, Eagle etj.

Programet e shërbimit në qendrat rezidenciale janë përmirësuar çdo vit dhe stafi është trajnuar për të përmirësuar punën në shërbim të fëmijëve. Një risi e viteve të fundit është përfshirja e psikologëve si në shkolla ashtu dhe në qendrat rezidenciale për t'i dhënë mbështetje psikologjike fëmijëve; madje fëmijët që janë jashtë kujdesit prindëror kanë jo pak probleme dhe u nevojitet një trajtim i veçantë.

Fakt është që në Shqipëri vitet e fundit janë bërë përmirësime në legjislacion për fëmijët në përgjithësi dhe për këtë target grup fëmijësh. Kjo ka sjellë reduktimin e dhunës fizike e psikologjike si në shkolla ashtu dhe në qendrat rezidenciale ku prezent janë vetëm fëmijë. Por jo gjithmonë ka njohje të zbatim të ligjit për fëmijët e veçanërisht për kategorinë e fëmijëve që ne kemi marrë për studim. Këto fëmijë gëzojnë të drejta si çdo fëmijë tjetër duke përfshirë këtu: të drejtën për t'u ushqyer, për t'u arsimuar, për t'u shprehur lirisht, e drejta për kujdes shëndetësor, e drejta për mbrojtje sociale.

Në Durrës operojnë një sërë organizatash që në fokusin e tyre kanë dhe fëmijët si p.sh Organizata e Jetimëve, CRCA, PNUD, World Vision, si dhe Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, organizata të cilat realizojnë aktivitete të ndryshme sensibilizuese, argëtuese etj për fëmijët si dhe ndërmarrin programe të ndryshme për tu ardhur në ndihmë.

Në mbështetje të ligjit 10347 datë 04.11.2010 '*Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*' pranë Këshillit të qarkut Durrës është ngritur **Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve** me Urdhër Nr.46 datë 20.03.2012. Kjo njësi ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në qarkun Durrës duke ngritur për çdo bashki e komunë një njësi e cila merret me mbrojtjen e fëmijëve, zbulimin dhe evidentimin e rasteve ku ka shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe raportimin e këtyre rasteve tek policia ose institucionet përkatëse. Por në momentin që po flasim nuk ka ende një strategji të mirëfilltë për mbrojtjen e fëmijëve dhe kjo është një mangësi në qarkun e Durrësit pasi ende nuk ka një plan konkret për rritjen e mirëqenies tek fëmijët në përgjithësi e jo më për fëmijët jashtë kujdesit prindëror për të cilët mungojnë strategji dhe plan veprimi dhe në bashkitë e qarkut (zyrës për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkisë). Kjo është një mangësi shumë e madhe dhe duhen ndërmarrë hapa konkretë për zhvillimin e një strategjie e cila të vihet në veprim që të ketë një përmirësim sado të vogël në jetën e fëmijëve të cilët janë jashtë kujdesit prindëror.

E Drejta për Arsim

E drejta për arsim është një ndër të drejtat bazë për edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve. Si të gjithë fëmijët, edhe fëmijët të cilët ndodhen në qendrat rezidenciale ndjekin shkollat e komunitetit pranë qendrave ku banojnë. Fëmijët të cilët frekuentojnë shkollat fillore pranohen më lehtësisht në shkolla ndoshta sepse paragjykimet në moshat e vogla janë të pakta, por nuk ndodh kështu me fëmijët të cilët frekuentojnë gjimnazin, të cilët hasen me paragjykime nga statusi i tyre si dhe për mënyrën e veshjes. Në qendrën rezidenciale në Bubq ka fëmijë të cilët

frekuentojnë gjimnazin madje 2 prej tyre edhe shkollën e lartë. Fëmijët shfaqin interes për arsimimin e tyre dhe kanë një nivel mesatar në shkollë.

E Drejta për Mbrojtje Sociale

Ligji Nr. 7710 dt 18/05/1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, ka njohur disa ndryshime të vazhdueshme në përpjekje për të lehtësuar përfitimin e ndihmës ekonomike nga kategori të caktuara. Pavarësisht këtyre iniciativave ligji i vitit 1993 përmban një klauzolë e cila pengon të ardhurit nga zonat e tjera të vendit për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike. Kjo ka bërë që të mbeten jashtë një numër i madh i familjeve të varfra të ardhur e të vendosur në zonat periferike e rurale të qarkut. Mungesa e të ardhurave dhe mos përfshirja në skemën e ndihmës ekonomike i bën fëmijët e këtyre familjeve kontingjent për braktisje apo strehim në qendra rezidenciale .

Historia që do të lexoni më poshtë është historia e dy vajzave të cilat ishin pjesë e fokus grupit të intervistuar tek qendra rezidenciale ne Durrës dhe është një shembull i shkeljes së të drejtave të fëmijëve nëpërmjet dhunës fizike e psikologjike në familje.

Historia e dy motrave të braktisura

Dy motra aktualisht strehohen në qendrën rezidenciale “Shtëpi familje” në Durrës. Ato kanë jetuar më parë me prindërit, motrat dhe vëllezërit e tyre. Familja është një familje me shumë fëmijë. Për shkak të vështirësive ekonomike të familjes, vajzat nxirreshin në rrugë nga babai i tyre për të lypur dhe fitimet e ditës i merrte ai. Babai ishte i alkoolizuar dhe shpesh përdorte dhunë fizike dhe psikologjike tek të gjithë pjesëtarët e familjes. Një ditë nëna e vajzave sëmuret, dërgohet në spital dhe aty ajo diagnostikohet me kancer në stomak. Gjendja e nënës rëndohej dhe vajzat vazhdonin të lypnin në rrugë dhe nuk frekuentonin më shkollën. Pas disa kohësh i vdes e ëma dhe vajzat ngelin të vetme me të atin dhe një motër tjetër, ndërsa vëllezërit dhe motrat e tjera ishin martuar dhe nuk kujdeseshin për to. Një muaj e gjysmë pas vdekjes së nënës, i ati pëson aksident dhe vdes rrugës për në spital. Vajzat mbesin vetëm dhe pa asnjë mbështetje. Pasi u strehuan në institucionin e shtëpisë së fëmijës ne Durrës morën trajtim psikologjik dhe shëndetësor nga stafi dhe u regjistruan në shkollë publike “Eftali Koçi” për të ndjekur arsimin e detyruar. Në bazë të ligjit, shtëpia e fëmijës pret 1 vit që të afërmit e dy motrave të interesohen për to dhe më pas fillojnë procedurat për birësim. Tani për to është interesuar një familje nga ShBA. Janë përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe për disa javë vajzat do të nisen për në Amerikë.

E Drejta për Mbrojtje Ligjore

Për sa i përket të drejtave të kësaj fushe fëmijët i gëzojnë ato që në momentin e ardhjes në jetë. Por në Shqipëri kemi mungesë të qendrave të cilat ofrojnë mbështetje ligjore për fëmijët jashtë kujdesit prindëror. Këto qendra do t'i ndihmonin fëmijët e kësaj kategorie kur ata mbushin moshën për tu larguar nga qendrat rezidenciale.

E Drejta për Pjesëmarrje

Pjesëmarrja e fëmijëve është një nga shtyllat kryesore të Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve dhe Planit të Veprimit 2005-2010 të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr 368 datë 31.05.2005 dhe nënkupton që fëmijët të dëgjohen duke siguruar lirinë e tyre si dhe të marrin në konsideratë mendimet e tyre kur trajtohen çështje të lidhura me ta. Këtu mund të themi se mësuesit si dhe drejtues të qendrave ku këta fëmijë trajtohen duhet të bëjnë përpjekje për t'i integruar fëmijët jashtë kujdesit prindëror në strukturat shoqërore disa prej të cilave po i rendisim më poshtë. Në qytetin e Durrësit janë ngritur dhe përforcuar disa organizma përfaqësuese të fëmijëve.

Qeveria e nxënësve.

Kjo strukturë është e ngritur në çdo shkollë dhe në bazë të Dispozitave normative të sistemit parauniversitar.

Parlamenti Rinor Durrës

Kjo strukturë është ngritur dhe mbështetur nga UNICEF që në vitin 2002 dhe përfaqëson interesat dhe zërin e fëmijëve nga mosha 14-18 vjeç. Përfaqësuesit e kësaj strukture zgjidhen në mënyrë të hapur çdo dy vjet. Është një strukturë përfaqësuese në rang qarku të Durrësit por përfaqësuesit e shkollave nga zona e Krujës e kanë të vështirë të bëhen pjesë aktive e nismave, aktiviteteve, fushatave etj të organizuar gjatë kësaj periudhe te ekzistencës.

Parlamenti i fëmijëve

Ky organizëm i fëmijëve funksionon në bazën të përzgjedhjes së përfaqësuesve nga senatet e shkollave të ciklit bazë, 9 vjeçar.

Kjo strukturë mbështetet si një strukturë shtetërore nga Drejtoria Arsimore Durrës dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve në Durrës dhe ka si funksione të ndjekin veprimtaritë e senateve të shkollës dhe mbështesin veprimtaritë e tyre.

IV. Prezantimi i gjetjeve kryesore

Gjatë punës së kryer për këtë studim janë nxjerrë disa fakte të cilat do të renditen si më poshtë:

Në përgjithësi kushtet në qendrat rezidenciale në Durrës e Bubq ishin të mira përveç disa problemeve që kishte qendra e Durrësit me lagështinë në katin e sipërm. Gjithsesi të dyja qendrat kishin fonde të vazhdueshme nga donatorë dhe pushteti lokal. Qendra e Durrësit kishte problem me fondet për aktivitetet e fëmijëve jashtë ambienteve të rezidencës, pra ka një shkurtim të fondeve nga ana e bashkisë.

Qendra rezidenciale e Bubqit merr fondet nga shoqata “Betania” e cila ka qendrën në Itali por problemi që ngrihej nga stafi i kësaj qendre ishte se nuk merrnin asnjë fond nga pushteti lokal.

Në qendrat rezidenciale publike moshë deri kur mund të qëndrojnë fëmijët pranë tyre është 14 vjeç, pas kësaj moshe largohen nga qendra rezidenciale dhe/ose strehohen në konvikte e shkollave ku studiojnë, ose në rastin më të mirë transferohen në ndonjë qendër tjetër rezidenciale private. Por kjo sjell probleme të fëmijët, ata largohen në një moshë fare të vogël, pa asnjë mbështetje. Kjo i shtyn ata drejt rrugës së kimit ose të bien pre e trafikëve.

Duhet të rritet moshë e qëndrimit të fëmijëve në qendrat rezidenciale ose duhet të krijohen qendra për adoleshentët deri në moshën 18 vjeç.

Nga takimi me stafin e Shtëpisë së Foshnjës në Durrës rezultoi se puna e tyre ishte mjaft e kujdesëshme kundrejt fëmijëve që strehojnë duke filluar nga ushqimi dhe kujdesi shëndetësor. Shumë familje të varfra, për shkak të pamundësive financiare, detyrohen t’i lenë fëmijët e tyre në qendrat rezidenciale përgjatë gjithë ditës, me qëllim që fëmijët të mund të ushqehen në këto qendra. Shqetësues mbetet fakti që disa prindër nuk kthehen t’i marrin fëmijët e tyre dhe pas një periudhe 1 vjeçare nisin procedurat e birësimit për këtë kategori fëmijës.

Gjatë takimit me fëmijët e Shtëpisë së Foshnjës Durrës, u vu re se ata ishin fëmijë të ndrojtur dhe të pashoqërueshëm, pavarësisht përpjekjeve të stafit për t’i solidarizuar këta fëmijë. Ky fakt përbën një problem në moshën kur ata duhet të largohen nga qendra pasi përballen me vështirësi të cilat nuk do të mund t’i menaxhojnë në një të ardhme. E njëjta situatë rezultoi edhe në takimin me fëmijët e tjerë të kësaj qendre që ndodhet në qytet, madje ata shkojnë në shkolla publike por përsëri mbeten fëmijë të ndrojtur.

Duhet të ketë ndërgjegjësim për birësime në moshë të vogël gjë e cila i stabilizon fëmijët në një ambient familjar ku mund të rriten e jetojnë, ndryshe nga qendrat rezidenciale që sado i kualifikuar të jetë stafi, nuk mund të zëvendësojë ambientin familjar.

Shihet e nevojshme hartimi i strategjive për fëmijët nga ana e bashkive dhe qarkut Durrës dhe duhet të krijohet një sistem të dhënash për fëmijët të cilët nuk figurojnë të regjistruar në qendra rezidenciale, pra ata fëmijë të cilët jetojnë me të afërmit ose janë të braktisur dhe nuk dihet fati i tyre.

V. Rekomandime

1. Hartimi i politikave sociale me synim ndërhyrjen dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike të familjeve duke ndikuar në uljen e numrit të fëmijëve jetim social.

2. Rritja e numrit të qendrave ditore multi-disiplinare për fëmijët dhe shtrirja e tyre në të gjithë qarkun.

3. Duhet të rritet mosha e qëndrimit të fëmijëve në qendrat rezidenciale ose duhet të krijohen qendra për adoleshentët deri në moshën 18 vjeç.
4. Duhet të ketë një ndërgjegjësim të birësimeve në moshë të vogël. Kjo i mundëson fëmijëve të rriten në një ambient familjar.
5. Duhet të hartohet një strategji për fëmijët nga ana e bashkisë dhe qarkut Durrës dhe duhet të krijohet një sistem të dhënash për fëmijët e peregjistruar në qendrat rezidenciale.
6. Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik për respektimin e të drejtave të kësaj kategorie fëmijësh por dhe rritja e vullnetarizmit.
7. Rritja e financimeve nga aktorët lokalë apo OJF të ndryshme për këto qendra, me qëllim mbulimin e shpenzimeve..
8. Pjesë e rëndësishme është dhe trajnimi i stafit, ka nevoja të vazhdueshme që të rritet kualifikimi i stafit .

BIBLIOGRAFI

Strategjia Kombëtare të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për vitet 2005-2010,
Strategjisë Sektoriale e Përfshirjes Sociale 2007-2013 dhe Planit të Veprimit të fundit 2012-
2016.

Qendra Kombëtare Shqiptare për Studimet Sociale & Fshati i Fëmijëve SOS “Analiza e situatës
së të Drejtave të Fëmijëve”; Mirela Muca, Vilma Kolpeja, Almandina Guma, Mars 2009.

Raport i Avokatit të Popullit (viti 2012) “Për të drejtat e fëmijëve jetimë, përfshirë këtu fëmijët e
sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, si dhe të fëmijëve që
shfrytëzohen për të punuar”.

Raport studimor “Vlerësim i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës dhe I institucioneve për fëmijët
pa kujdes prindëror” (financuar nga UNICEF, Shqipëri); Tetor 2005;

ANEKS 1:Pyetjet që janë përdorur për drejtuesit tek fokus grupet: (Durrës e Bubq)

1. Numri i fëmijëve që trajtohen në këtë institucion
2. A ka dosje personale për çdo nga fëmijët me të dhënat përkatëse
3. Sa fëmijë janë larguar për vitin 2011 dhe arsytet e largimit
4. A mbështeten këta fëmijë në momentin e largimit dhe a vizitohen fëmijët nga stafi pas largimit nga institucioni
5. Sa interesohen prindërit e fëmijëve që strehon në këtë qendër
6. Përsa i përket ushqimit që marrin këta fëmijë a është i shëndetshëm, a gatuhet në kushte të mira higjieno sanitare
7. A përfshihen fëmijët në vendimmarrje dhe a këshillohen nga stafi në jetën e tyre të përditshme
8. A ka qendra juaj një mjek i cili bën vizita periodike për çdo fëmije dhe si është ecuria e tyre a vaksinohen rregullisht
9. Tek pjesa e arsimit si është ecuria e fëmijëve, a nxitet edukimi i tyre, a kanë ambiente për studim dhe si janë rezultatet e tyre në shkollë
10. Si organizohet koha e lirë për fëmijët
11. Përsa i përket personelit: a ka një kod sipas të cilit duhet të sillen e te jetë i trajnuar personeli dhe a kanë sugjerime e ankesa fëmijët për stafin
12. A ofron shtëpia kushte të përshtatshme për të jetuar dhe si janë kushtet e saj. Viti I ndërtimit, A është ri-konstruktuar?
13. A ndjehen këta fëmijë të barabartë në ambientet publike dhe sa përfshihen në veprimtaritë publike dhe aktivitete të ndryshme. Cfare mund të bëhet më shumë për përfshirjen e tyre sociale
14. Sa është buxheti që merr qendra nga pushteti lokal

ANEKS 2: Pyetjet që janë bërë tek fëmijët në fokus grupet (Durrës e Bubq)

1. Cilat janë anët e mira dhe te këqija të rritjes së fëmijëve në qendra rezidenciale
2. A janë lehtësisht të pranueshëm në shoqëri, shkollë etj
3. Nëse do të jepej mundësia ta ndryshoje vendin e qëndrimit çfarë do të bëje
4. Je më mirë në këtë qendër apo tek ndonjë i afërm
5. Cfare ushqimi hani në këtë qendër dhe a jeni te kënaqur
6. Nëse do të jepej mundësia të bëje ndonjë ndryshim në këtë shtëpi çfarë do të bëje